



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Data: 19 Mars 2018

NJOFTIM

Informacion në lidhje me kërkesat e Shoqatës së Gjinekologëve privat në Republikën e Maqedonisë

Fondi për Sigurim Shëndetësor i Maqedonisë njofton opinionin publik në lidhje me kërkesat e reafirmuara të gjinekologëve përmes mediave në vend.

Mjekët amë gjinekologë janë një hallkë e rëndësishme e sistemit shëndetësor për shkak të kujdesit për shëndetin riprodhues të grave dhe të njejtit janë në numër më të ulët nga ajo që është e parapëme në nivel Republikan. Fondi për Sigurim Shëndetësor e pranon këtë fakt dhe mu për këtë në vazhdimësi mban takime të rregullta me Shoqatën e gjinekologëve privat të Maqedonisë.

Është e vërtetë se takimi i fundit ishte para dy muajsh, ku shoqata parashtrroi disa kërkesa, kryesisht kërkesa nga aspekti financiar.

Fondi për Sigurim Shëndetësor gjithmonë merr vendime në interes të të siguruarve dhe kryesisht në sigurimin e cilësisë dhe mbrojtjes së shëndetit, kështu që edhe kësaj here do e rishikojmë mundësinë e përafritimit për kapitacionin e mjekëve amë gjinekologët me mjekët e tjerë. Por kjo implikon burime të reja financiare.

Fondi për Sigurim Shëndetësor nuk preferon që me partnerët e vetë strategjik të komunikojë përmes medimeve, dhe për këtë dëshirojmë që ta informojmë opinionin publik se është planifikuar një takim i Fondit për Sigurim Shëndetësor me përfaqësues të Shoqatës së gjinekologëve private të Maqedonisë. Të gjitha vendimet që do të merren në këtë takim do të publikohen në kohën e duhur.

Sa për informacion duhet të kemi parasyshë që gjinekologët janë mjekët më të paguar në Republika Maqedoni, me një pagesë mesatare mujore prej 169.000 denarë për një tim. Sa për krahasim, ajo është më shumë se 55.500 denarë nga shuma që fondi pagan për mjekët e përgjithëshëm familjarë.